Kronikë

Vrau recepsionistin e hotelit në Dhërmi dhe i fshehu trupin, çohen letrat në Greqi, kërkohet ekstradimi i Gerald Shehut

Është zbardhur krimi makabër në Dhërmi, ku pronari i hotelit Gerald Shehu vrau recepsionistin Erald Nevruzi e mandej fshehu kufomën. Dyshohet se shkak është trafiku i drogës, megjithatë nuk përjashtohet as pista e një konflikti për punën në hotel. Trupi i pajetë i 31-vjeçarit u gjet sot në Vuno pas arrestimit të dy punëtoreve që kanë bashkëpunuar me pronarin në krim.

Armand Xhelili
7 Qershor, 16:26 | **Përditesimi: 7 Qershor, 16:45**

Share

Vlore- Pronari i hotel "Greccia" në Dhërmi, Gerald Shehu e kishte planifikuar vrasjen e recepsionistit, Erald Nevruzi. I riu kishte vetëm një javë që kishte filluar punë në hotelin ku gjeti vdekjen, por nga të dhënat hetimore mësohet se ata mund të kenë pasur njohje më parë në Angli. Atje dyshohet se ka lindur konflikti për trafik droge, por gjithsesi kjo piste ende nuk është përfundimtare. Burimet thane se pista e dytë është ajo e konfliktit për punën në hotel.

Krimi makabër i vrasjes dhe fshehjes së kufomës ndodhi pak pas mesnatës së 5 qershorit duke u gdhirë 6 qershori.

Gerald Shehu e qëlloi me dy plumba pistolete recepsionistin 31-vjecar në shkallët e hotelit, tërhoqi trupin zvarrë deri në katin e nëndheshëm, siç shihet dhe nga gjurmët e gjakut në dysheme, ku kreu gjithë planin për fshehjen e trupit.

LEXO EDHE:
Vrasja e recepsionistit të hotelit në Dhërmi, ndalohet shoferi i morgut, filmoi trupin e pajetë të Eraldit për tia dhënë gazetarit

Në këtë krim kanë marrë pjesë si bashkëpunëtor, dy punëtorë të hotelit, Daniel Qosja dhe David Larti, të cilët janë arrestuar nga policia. Nga dëshmia e tyre është zbardhur gjithë dinamika e ngjarjes së rëndë. Po kështu sot është gjetur trupi i pajetë i viktimës në zonën e Gjipesë pranë një guroreje.

Të arrestuarit kanë deklaruar se pronari i ka detyruar ta ndihmojnë për zhveshjen e kufomës, djegien e rrobave në furrën e picave. Më pas pronari me ndihmën e punëtoreve e ka mbështjellë trupin e viktimës me plastmas e çarçafë dhe e kanë futur në bagazhin e makinës. Autori i krimit është larguar drejt Gjipesë ku ka hedhur trupin e pajetë të recepsionistit.

Pas krimit, Shehu ka udhëtuar drejt Greqisë rreth 4 orë pas krimit, ç'ka ka pasur kohë të ndërrohej në shtëpi dhe te merrte pasaportën. Me makinën "Audi A8" ka udhëtuar deri në Sarandë, pastaj ka fshehur makinën dhe ka udhëtuar me taksi për në doganën e Qafë Botës. Nga aty drejt Korfuzit, ku u kap nga policia greke, në tentativë për tu arratisur në Angli, ku dhe jetonte.

Burime nga policia thanë se është dërguar dokumentacion dhe pritet ekstradimi në Shqipëri i Gerald Shehut. Policia e Vlorës ka sekuestruar shumë prova materiale dhe ka mbledhur dëshminë e turisteve ne hotel dhe vjehrrës se autorit, bashkëpronare e hotelit. Të gjitha këto çuan në zbardhjen e shpejtë të ngjarjes, por ende nuk është gjetur arma e krimit.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: gerald shehu | david larti | Daniel Qosja | eraldo nevruzi | Vlore

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:
Rithemelimi rikthen kaosin në Kuvend, si e vlerësoni?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Dy turistë lituanezë bllokohen në Gjirin e Anglezit në Karaburun! I shpëtojnë policia kufitare e Himarës 9 (VIDEO)
8 Qershor, 08:57

Vlorë/ Aksident në lagjen 'Ali Demi', automjeti përplas një të moshuar
7 Qershor, 20:48

Arqile Bollano është kryetari i ri i komanduar për Himrën! Pervin Gjikuria u tërhoq nga gara! Kreu i Këshillit: Ka eksperiencën e duhur
7 Qershor, 16:35

Vrasja e recepsionistit në Dhërmi, gazetari Dema zbulon detajet: Hetohet dhe prishja e pazareve të drogës! Ende nuk është gjetur arma e krimit
7 Qershor, 14:29

Njollat e gjakut nëpër tokë, pamjet nga vendi ku u gjet recepsionisti i hotel 'Greccia' në Dhërmi! Pasi e vrau, pronari e hodhi në përrua
7 Qershor, 14:22

Shkodër, Kukës e Vlorë asgjësohen 6065 bimë kanabis! Në hetim 4 vëllezër, 2 kryepleq dhe 2 inspektorë pyjesh
7 Qershor, 12:26

Nuk vendosen impiante për ujërat e zeza, gjobiten 8 hotele në Sarandë! Demokratët: Të anulohen gjobat! Çipa: Balluku na premtoi shtyrjen e afatit policinë
Limos Didani
7 Qershor, 12:16

DETAJE TE REJA/ Vrasja në hotelin Greccia në Dhërmi, zbulohet ku u gjet trupi i recepsionistit! Turistja dëgjoi krismat, vjehrra e pronarit telefonoi policinë
7 Qershor, 11:21

Dhërmi/ Arrestohen 2 turistë anglezë, dyshohet se shpërndanin drogë në Kala Festival
7 Qershor, 11:08

U vra me dy plumba në kokë, gjendet trupi i recepsionistit të hotel 'Greccia' në Dhërmi! Arrestohen 2 punonjësit, ndihmuan pronarin ta fshehë
7 Qershor, 07:31

Turistja franceze kishte humbur në Vlorë, zjarrfikësit e gjejnë në malin e Çikës
6 Qershor, 18:53

Ekzekutohet recepsionisti i hotel 'Greccia' në Dhërmi, arrestohet në Greqi autori, bashkëpronar i hotelit! E qëlloi më plumb në kokë e i zhduku trupin! Pistat ku po hetohet
Armand Xhelili
6 Qershor, 15:55

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje